

	<b>RREGULLORJA E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR GARANTIMIN E STANDARDEVE TË CILËSISË INSTITUCIONALE DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-048-AL		1	12.06.2019	1 / 4

## Neni 1

### Baza ligjore e rregullores

Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e Komisionit të përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit (më poshtë “Komisioni”) i Kolegjit Universitar “Bedër” mbështetet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e institucionit si dhe në dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë.

## Neni 2

### Objekti i punës së Komisionit

Komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë institucionale është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit.

## Neni 3

### Funksionet e Komisionit

Komisioni kryen funksionet e mëposhtme:

1. Miraton politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë.
2. Miraton standarde dhe procedura që zbatohen në mënyrë uniforme në njësitë e institucionit, duke marrë për bazë profilin e IAL.
3. Përcakton kritere dhe masa që mundësojnë të identifikohet suksesi dhe mos përmbushja e objektivave në veprimtarinë e institucionit.
4. Miraton, monitoron dhe kryen vlerësime periodike të programeve, në bashkëpunim me njësitë e tjera të Kolegjit.
5. Monitoron sigurimin e cilësisë së stafit akademik.
6. Koordinon ndërlidhjen me njësitë e tjera kryesore dhe bazë të institucionit dhe menaxhon sistemin e informacionit ndërmjet këtyre njësive.
7. Nxjerr urdhra dhe direktiva që i zbaton Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

## Neni 4

### Kryetari i Komisionit

1. Komisioni drejtohet nga kryetari, i cili zgjidhet me shumicën e votave të gjithë anëtarëve të këtij organi.
2. Kryetari i Komisionit drejton mbledhjen e tij, drejton diskutimet dhe siguron marrjen e vendimeve të drejta.

## Neni 5

### Zhvillimi i mbledhjeve

*(Pika 1 ndryshon me vendim senati nr.1, datë 12.06.2019)*

1. Mbledhjet e Komisionit thirren nga Kryetari dhe zhvillohen sipas programit vjetor të përcaktuar nga ky i fundit, por në çdo rast jo më pak se 2 (dy) herë në vit.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR GARANTIMIN E STANDARDEVE TË CILËSISË INSTITUCIONALE DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-048-AL		1	12.06.2019	1 / 4

2. Rendi i ditës së mbledhjeve të Komisionit vendoset nga Kryetari. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar Komisionit nga anëtarët e tij dhe që janë në kompetencë të këtij organi. Kërkesa për të përfshirë një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 5 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen. Rendi i ditës duhet t'i shpërndahet të gjithë anëtarëve, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.
3. Mbledhjet janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma anëtarëve të tij.
4. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, Kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së parës.
5. Kryetari mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.
6. Në rast mungese të tij, për arsye objektive për një mbledhje të njoftuar, Kryetari zëvendësohet, nga një anëtar i caktuar prej tij.
7. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme edhe kur nuk respektohen procedurat e parashikuara për thirrjen dhe zhvillimin e saj, vetëm në rast se në atë mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët me të drejtë vote, të cilët, paraprakisht, miratojnë zhvillimin e mbledhjes.

#### **Neni 6**

##### **Vendimmarrja**

Mbledhja e Komisionit quhet e vlefshme, në rast se në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Në rast barazimi, vota e kryetarit të mbledhjes është vendimtare.

#### **Neni 7**

##### **Procesverbali i mbledhjes**


1. Në çdo mbledhje mbahet një proces-verbal, ku bëhet një përmbledhje e problematikës së mbledhjes, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
2. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet se bashku nga kryetari dhe sekretari.

#### **Neni 8**

##### **Zbardhja e Vendimeve**

Vendimet e Komisionit, zbardhen nga sekretari, jo më vonë se dy ditë nga përfundimi i mbledhjes. Ato hartohen në tre kopje, të cilat nënshkruhen nga Kryetari dhe marrin vulën e Kolegjit Universitar "Bedër". Kopja e sigluar nga sekretari, administrohet në protokollin e institucionit, ndërsa dy kopjet e tjera shpërndahen tek njësitë që i adresohet.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR GARANTIMIN E STANDARDEVE TË CILËSISË INSTITUCIONALE DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT</b>				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-048-AL		1	12.06.2019	1 / 4

### Neni 9

#### Mënyra e shpërndarjes së informacionit ndërmjet njësive

Komisioni organizon grumbullimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe të dhënave brenda institucionit me qëllim përpunimin e tyre nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Ky funksion përfshin:

1. Vendosjen e prioriteteve dhe objektivave;
2. Përballimin e presionit në arritjen e objektivave;
3. Kompetenca e aftësi;
4. Koordinimin e bashkëveprimit me njësi të ndryshme të institucionit (akademike dhe administrative);
5. Bashkëpunimin dhe ndërveprimin me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
6. Monitorimin e performancës së institucionit.

### Neni 10

#### Organizimi i planifikimit strategjik

Komisioni në planifikimin e tij strategjik përfshin aktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Aktorët e brendshëm janë:

- Trupa menaxhuese
- Stafi akademik
- Studentët
- Stafi ndihmës.

Aktorë të jashtëm janë:

- Agjencitë qeveritare
- Sektori privat
- Media
- Alumni.

### Neni 11

#### Përbërja e Komisionit dhe kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve

Komisioni shtrihet në nivel institucional. Ai përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandate dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.


### Neni 12

#### Koordinimi i procesit të sigurimit të cilësisë

Komisioni ngarkohet të koordinojë procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Përgjegjësitë e tij do të përfshijnë:

- a. Organizimin e një rrjeti cilësie të brendshëm;
- b. Nxitjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet njësive;
- c. Zhvillimin e procesit të nxënies në tre hapa: mëso, apliko, shpërndaj;
- d. Riorganizimin e aftësive specifike në institucion;

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati

	<b>RREGULLORJA E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR GARANTIMIN E STANDARDEVE TË CILËSISË INSTITUCIONALE DHE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT</b>			
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit
BU-REG-048-AL		1	12.06.2019	1 / 4

- e. Promovimin e ideve inovatore me qëllim zgjidhjen e problemeve;
- f. Matjen dhe evidentimin e përmirësimeve në arritjen e cilësisë;
- g. Sigurimin e cilësisë;
- h. Analizimin e raporteve të përvitshme që vijnë nga cdo njësi rreth aktiviteteve të kryera, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;
- i. Auditimin e aktiviteteve në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

### Neni 13

#### Publikimi i rezultateve të vlerësimit

Publikimi i rezultateve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" ( Bedër) është i detyrueshëm. Raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Kolegjit Universitar "Bedër" dhe raporti i komisionit të përherëshëm për sigurimin e cilësisë institucionale publikohen në faqen e internetit.

### Neni 14

#### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga senati akademik i Kolegjit Universitar "Bedër".

### Neni 15

#### Zbatimi

Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga rektori i Kolegjit Universitar "Bedër"

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Komisioni i Përherëshëm për Sigurimin e Cilësisë	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë	Senati